



**Instituti Kombëtar i
Shëndetësisë Publike të Kosovës**

RAPORTI I AERONDOTJES

JANAR-MARS 2009



Prishtinë, 21 prill 2009

Parathënie

Njëri nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të shëndetësisë publike në Republikën e Kosovës është vendosja e një sistemi të mbikëqyrjes së kontaminimit të ajrit.

Deri më sot nuk kemi pasur informata të mjaftueshme për të monitorimin e kualitetit të ajrit në Kosovë. Kështu me kompletimin e pajisjeve moderne Air Pointer kemi filluar nga 1 janari 2009 të përcjellim kualitetin e ajrit në dy pika matëse (IKSHPK dhe MEF-Ministria e Ekonomisë dhe Financave).

Duke ngritur një sistem të tillë të mbikëqyrjes së kualitetit të ajrit ne do të përcjellim në vazhdimësi në periudha kohore tremujore e vjetore variacionet e kontaminimit në kryeqytet duke vazhduar me monitorimin e grimcave të ajrit në të gjitha qytetet e Republikës së Kosovës dhe vendbanimet potencialisht të rrezikuara nga kontaminimi i ajrit.

Ky hulumtim është i pari i këtij lloji në Kosovë dhe si i tillë hap perspektivën për vazhdimin e hulumtimeve të reja e me këtë realizimin e objektivave të parashtruara në Strategjinë tonë duke dhënë edhe rekomandimet të cilat mundësojnë përmirësimin e kualitetit të ajrit e me këtë edhe ruajtjen e shëndetit të rrezikuar të qytetarëve.

Duke qenë se pajisjet janë siguruar me mjete nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për kontributin e dhënë.

Prof. Dr. Naser Ramadani

**Drejtor i Institutit Kombëtar të
Shëndetësisë Publike të Kosovës**

RAPORTI I AERONDOTJES

JANAR-MARS 2009

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, respektivisht departamenti i Ekologjisë Humane, prej 01 janarit në mënyrë kontinuele përcjell kualitetin e ajrit në dy pika matëse (IKSHPK dhe MEF-Ministria e Ekonomisë dhe Financave). Përcjellja kontinuele mundësohet përmes paisjes gjegjëse AIRPOINTER e cila paisje për momentin regjistron koncentrimet e NO₂, SO₂ dhe grimcave të suspenduara.


Rezultatet e NO₂ në pikën matëse të MEF disa herë gjatë kësaj periudhe kanë tejkalluar koncentrimet maksimale të lejuara (grafikoni 1). Vlerat më të larta (100µg/m³-140µg/m³) janë regjistruar prej 07 -18 janar, pastaj 22 - 27 shkurt (110µg/m³) dhe prej 23- 29 mars (100 µg/m³ - 110µg/m³). VML e lejuar është 85µg/m³.

Rezultatet e NO₂ në pikën matëse në IKSHPK poashtu flasin për tejkallim të VML disa herë gjat muajit janar (13 dhe 18 janar) dhe më 22 shkurt (grafikoni 2).


Rezultatet e SO₂ në pikën matëse MEF dhe IKSHPK janë prezentuar në grafikonet 3 dhe 4, nga ku vërehet se për këtë periudhë kohore nuk kemi pas asnjëherë tejkallim të vlerave limite për këtë parametër. VML 150µg/m³.

Grimcat e suspenduara janë prezentuar në grafikonet 5 (MEF) dhe 6 (IKSHPK). Në të dy pikat matëse gjatë këtij tre mujori janë regjistruar vlera dukshëm më të larta se sa vlera limite (120 µg/m³) dhe atë më tepër se 18 herë është tejkalluar vlera prej 300µg/m³ e cila gjë lejohet të tejkallohet maksimalisht gjatë një viti.


Grafikoni 1. Koncentrimet e NO2 në pikën matëse MEF




Grafikoni 2. Koncentrimet e NO2 në pikën matëse IKSHPK




Grafikoni 3. Rezultatet e SO2 në pikën matëse MEF




Grafikoni 4. Rezultatet e SO2 në pikën matëse IKSHPK



Grafikoni 5. Grimcat e suspenduara në pikën matëse në MEF



Grafikoni 6. Grimcat e suspenduara në pikën matëse në IKSHPK



Përfundime

1. Ndotja e ajrit në Prishtinë është mbi normat e lejuara.
2. Shkarkimet nga automjetet (grimcat e suspenduara dhe pluhuri) që krijohen në rrugët e kryeqytetit kontribuojnë në rritjen e ndotjes së ajrit duke shkaktuar probleme shëndetësore si: vështësi në frymëmarrje, probleme të sistemit kardiovaskular, dëmtim të sistemit imunitar, anemi, çrregullime të sistemit imunitar, çrregullime të të pamurit, etj.
3. Rritja e intensitetit të qarkullimit të automjeteve, numri i tyre në rritje, përdorimi i karburanteve pa kontrollë përkatëse me përmbajtje të lartë të plumbit, përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje, ndërtimet pa plan dhe pa leje, afrimi i qendrave të banuara pranë zonave industriale, pakësimi i zonave të gjelbëruara, janë disa nga indikatorët që ndikojnë në rritjen enorme të ndotjes së ajrit.
4. Grupet më të ndjeshme të popullatës nga aerondotja janë fëmijët dhe personat me sëmundje kronike, ku si pasojë shfaqen: sëmundjet respiratore (astma, alergjia), çrregullimet e zhvillimit mendor, tumoret e fëmijëve dhe çrregullimet endokrine;
5. Në bazë të raportit 2008 Instituti Kombëtar ka regjistruar gjithsej 13.136 sëmundje ngjitëse të organeve respiratore (12%) nga raportimi total i sëmundjeve ngjitëse. Nuk raportohen të dhënat për sëmundjet kronike respiratore nga Institucionet tona shëndetësore.

Rekomandime

1. Urgjentisht të përpilohet një plan aksioni për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe të aprovohet me procedura urgjente nga Parlamenti i Kosovës.
2. Largimi i menjëhershëm i automjeteve të vjetra nga qarkullimi.
3. Pajisja e të gjitha automjeteve me katalizator.
4. Aplikimi i një takse komunale për të gjitha automjetet që futen në kryeqytet.
5. Përforcimi i rrjetit të trafikut urban me karburante ekologjike
6. Rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit.
7. Larja e përgjithshme e rrugëve të kryeqytetit.
8. Ekspertët e Institutit Kombëtar paralajmërojnë dhe alarmojnë se poqese nuk merren masa urgjente, humbja e pritshme e jetëgjatësisë së banorëve do të jetë enorme.



Copyright: IKSHPK, prill 2009